

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit O.G. nga ..., për shkak të veprës penale Marrja e ryshfetit nga neni 428 par. 1 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë PKR.nr.72/2017 të datës 20.02.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 19.04.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë PKR.nr.72/2017 të datës 20.02.2018, **vërtetohet.**

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Pejë me aktgjykimin, PKR.nr.72/2017 të datës 20.02.2018, të akuzuarin O.G. konform nenit 364 par. 1 nën par. 1.3 të KPK-së e ka liruar nga akuza, për shkak të veprës penale , marrja e ryshfetit nga neni 428 par. 1 të KPK-së. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore. I dëmtuari është udhëzuar në kontest juridiko – civil lidhur me kërkesën pasurore-juridike.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

- Prokuroria Themelore në Pejë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që kjo Gjykatë aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit dhe ti shqiptoj dënimin plotësues konform nenit 62 par. 1 e 2 nënpar.2.3 të KPRK-së ose ta anulon dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit në Prishtinë, me parashtrësën me shkrim PPA./I.nr. 106/18 të datës 12.03.2018, ka propozuar që ankesa e Prokurorit Themelore në Pejë të aprovohet si e bazuar.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e kësaj lënde, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore konstatoi:

-ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë nuk është e bazuar.

Aktgjykimi i shkallës së parë ankimohet nga ana e Prokurorisë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike. Sipas prokurorisë shkeljet esenciale konsistojnë në faktin se aktgjykimi është i përpiluar në kundërshtim me nenin 370 par. 7 të KPP-së pasi nuk ka arritur që të paraqes qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për cilat arsye i ka konsideruar të vërtetuara apo të pavërtetuara dhe në mënyrë të veçantë të vlerësoj saktësinë e provave kundërtënëse. Ka paraqitur pjesë nga dëshmia e dëshmitarit – të dëmtuarit F.B., A.Sh., dhe ka përkthyer llojin e natyrës së operimit për të cilën thekson se nuk hynë në rastet urgjente, se është e ndaluar të marrin para kesh apo të sjell material mjekësor privat e që është rregulluar me ligjin për shëndetësi Rregulloret dhe Udhëzimet Administrative e që i pohon edhe i akuzuari. Se materiali që mungon i përcillet motrës e cila pastaj ua përcjellë të afërmeve të pacientit. Se i ka marrë hollat i akuzuari e pranon edhe ai vet e po ashtu se i dëmtuari është futur pa rend në operacion. Se është vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendja faktike pasi gjykata me të njëjtat prova njëherë e shpallë fajtor dhe pa administruar asnjë provë të re apo pa ekzistuar ndonjë rrethanë e re tani të akuzuarin e liron. Se vendimin gjykata e ka mbështetur kryekëput në mbrojtjen e të akuzuarit duke abstrahuar pjesën tjetër të dëshmisë së dëshmitarit A.Sh. të dhënë në prokurori e po ashtu se për shpenzimet e sallës nuk i ka dhënë kurrfarë dëshmie për këto të holla. Sipas Prokurorisë në rastin konkret është shkelur edhe ligji kur është marrë aktgjykimin lirues se fare nuk ka rëndësi motivi apo arsyeja pse i dëmtuari e ka paraqitur rastin pas tre muajve.

Pretendimi ankimor i prokurorisë se aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike është i pa bazuar. Aktgjykimi i shkallës së parë është i qartë dhe konkret, gjykata në arsyetimin e aktgjykimit ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, po ashtu në mënyrë të veçantë ka vlerësuar saktësinë e provave kundërtënëse dhe arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështjeje penalo-juridike. Arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë si të tilla i pranon edhe kjo gjykatë. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka marrë aktgjykimin lirues. Në tërësi Gjykata e Apelit e Kosovës i mbështetë arsyetimet dhe vlerësimet e provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësorë si dhe me vendosjen e kësaj çështjeje penalo-juridike ashtu siç ka vendosur gjegjësisht sa i përket aktgjykimit lirues. Gjykata e shkallës së parë për secilën provë të administruar ka dhënë vlerësimin dhe arsyetimin e të cilat me vëmendje i ka shqyrtuar edhe kjo gjykatë, e për cilat më konkretisht do të bëj fjalë si më poshtë. Nuk qëndron pretendimi i prokurorisë se aktgjykimi është i bazuar kryekëput në mbrojtjen e të akuzuarit por se kjo mbrojtje e të akuzuarit është e mbështetur edhe me prova të tjera e sidomos me dëshminë e dëshmitarit kyq si që është dëshmitari A.Sh. i cili është dhëndër i të dëmtuarit F. e i cili në të gjitha fazat e procedurës penale ka deklaruar se të

akuzuarit shumën prej 150 € ia ka dhënë për blerjen e materialit për operimin e syrit duke mos e kushtëzuar të njëjtin si dhe faktin se i dëmtuari nuk është takuar me të akuzuarin por të gjitha kontaktet dhe aranzhimet për operim dhe për blerjen e materialit janë kryer përmes dëshmitarit A.Sh. dhe të akuzuarit O.G.. Po ashtu edhe nga dëshmia e dëshmitarit S.D., J.G. dhe R.L. u vërtetua se në Spitalin Regjional të Pejës në të shumtën e rasteve nuk ka material për operim e që përputhet edhe me dëshminë e të akuzuarit. Pavarësisht se prokuroria pretendon se lajmërimi i rastit tre muaj pas operimit nuk është me rëndësi por qenësore është se kjo nuk e përjashton përgjegjësinë penale të kryesit, prapë se prapë edhe kjo gjykatë pajtohet se bazuar në provat e cekura më lartë dëshmia e të dëmtuarit nuk mund të merret si e bazuar pasi i njëjti nuk ka kontaktuar drejtpërdrejtë me të akuzuarin si dhe lajmërimin e rastit e bënë vetëm pasi i keqësohet gjendja shëndetësore e syrit, si dhe nga dëshmia e tij nuk mund të aprovohet pretendimi i prokurorisë i theksuar në dispozitiv të akuzës si i akuzuar “me kusht që ta operoj të dëmtuarin, paraprakisht kërkon dhe i merr të holla në shumë prej 150 €” pasi që kjo me asnjë provë nuk mundi ti vërtetohet. Prandaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë në mungesë të provave të akuzuarin O.G. e ka liruar nga akuza për veprën penale për të cilën është akuzuar nga ana e prokurorisë.

Meqë aktgjykimi nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, nuk kemi as shkelje të ligjit penal.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.109/18, më 19.04.2018

Procesmbajtësi,
Eroll Gashi _____

Kryetari i kolegjit – gjyqtari,
1. Mejreme Memaj _____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi _____

3. Afrim Shala _____